



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Departman za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

Ministria e Zhvillimit Ekonomik shpallë **KONKURS PËR AVANCIM** të nëpunësve civilë për këtë vend të punës:

Departamenti i Energjisë

Vendi i punës: Udhëheqës i Divizionit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, Efiçencës dhe Bashkëprodhimit - EZHE/070

Numri i Konkursit: APF0005774

Koeficienti : 9.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Mbikëqyrësi: Drejtori i Departamentit të Energjisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon punën e përgjithshme të divizionit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, Efiçencës dhe Bashkëprodhimit dhe ndihmon Drejtorin e Departamentit të Energjisë në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
- Menaxhon stafin e divizionit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, Efiçencës dhe Bashkëprodhimit, dhe në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit të Energjisë, organizon punën përmes ndarjes së detyrave të vartësit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit të divizionit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore;
- Ndihmon Drejtorin e Departamentit të Energjisë në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime / përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Menaxhon ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në fushën e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, Efiçencës dhe Bashkëprodhimit;

- Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, Efiçencën dhe Bashkëprodhimin dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- Ekzaminon dhe ofron komente rreth projektligjeve dhe akteve nënligjore dhe koordinohet me departamentin ligjor të institucionit për dizajnimin e rregulloreve rreth Divizionit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, Efiçencës dhe Bashkëprodhimit;
- Koordinon punën dhe bashkëpunon me menaxherët tjerë në institucion;
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë universitare në fushat: elektroteknike, mekanike, metalurgji, ekonomi dhe shkencat natyrore.
- Minimum 5 vite përvojë pune profesionale në sektorin e energjisë, veçanërisht në fushën e burimeve të ripërtërishme të energjisë, efiçencës dhe bashkëprodhimit.
- Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e energjisë (në veçanti në fushën e burimeve të ripërtërishme të energjisë, efiçencës dhe bashkëprodhimit);
- Aftësi komunikuese negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathtësi në caktim të objektivave , planifikim të punës dhe analizë në fushën e burimeve të ripërtërishme të energjisë, efiçencës dhe bashkëprodhimit;
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues ;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Vendi i punës: Udhëheqës i Divizionit të Standardeve dhe Rregullave Teknike - EZHE/090

Numri i Konkursit: APF0005775

Koeficienti : 9.00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Mbikëqyrësi: Drejtori i Departamentit të Energjisë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon punën e përgjithshme të divizionit dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave në sektorin e energjetik që kanë të bëjnë me identifikimin, adoptimin dhe zbatimin e standardeve dhe rregullave teknike dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;

- Menaxhon stafin e divizionit, dhe në bashkëpunim me Drejtorin, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek varësit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar shërbime profesionale dhe cilësore në fushën e zbatimit të standardeve dhe rregullave teknike;
- Ndihmon Drejtorin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime / përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës së divizionit; Përgjegjës për koordinimin e One Stop Shop-ve për BRE dhe projekteve ndërkuftare;
- Menaxhon ofrimin e njohurive dhe udhëzimeve profesionale në fushën e zbatimit të standardeve dhe rregullave teknike në sektorin e energjisë;
- Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me zbatimin e strategjisë së energjisë që kanë të bëjnë me standarde dhe rregulla teknike dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre;
- Ekzaminon dhe ofron komente rreth projektligjeve dhe akteve nënligjore dhe koordinohet me departamentin ligjor të institucionit për hartimin e rregulloreve rreth përfshirjes së standardeve dhe rregullave teknike në sektorin e energjisë;
- Koordinon punën dhe bashkëpunon me menaxherët tjerë në MZHE;
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë universiteti në fushat; mekanikë, elektroteknikë, xehetari dhe ekonomi.
- Përvoja të paktën 5 (pesë) vjet pune në detyra që lidhen me sektorin e energjisë
- Njohuri të larta për sektorin e energjisë;
- Shkathtësi organizative dhe komunikuese;
- Njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze si ne të shkruar ashtu edhe në të folur;
- Aftësi për punë efektive në mjedis shumetnik dhe shumë kulturor;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT PER AVANCIM

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunës civil ekzistues në MZHE, te cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. MZHE ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MZHE-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës, dy vlerësimet e fundit të punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

Afati i konkurrimit është prej datës 31/07/2019 deri me datë 07/08/2019, deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524.